

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – Departamenti për krime të rënda - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi , kryetari i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Driton Muharremi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Eroll Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.M. nga fshati ... Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.186/18 të datës 20.09.2018 , në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.nentor.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen**, si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ankesa mbrojtësit të akuzuarit A.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.186/18 të datës 20.09.2018, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.186/18 të datës 20.09.2018, të akuzuarin A.M., e ka shpallur fajtor për veprën penale veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim prej 1(një) viti, të cilin dënim është obliguar që ta mbajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin e shqiptuar iu është llogaritur koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës 18.06.2018 e deri më datë 20.09.2018.

Konformë nenit 69 të KPRK-së, te akuzuarit i është konfiskuar shufra metalike si mjete me të cilën është kryer vepra penale.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€, paushallin gjyqësorë, në shumë prej 50€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të

krimit të paguaj shumën prej 50€, e të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari K.B. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, është udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur Prokuroria Themelore në Prishtinë, lidhur me vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të lartë me burgim, e më të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M. –avokati B.C. nga Prishtina, lidhur me vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të ulët me burgim, respektivisht dënim burgimi të kushtëzuar, e më të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M. avokati B.C. gjithashtu ka parashtruar edhe përgjigje në ankesë të prokurorit duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën me shkrim PPA/L.nr.494/18, datë 26.10.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPRK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantuan : i dëmtuari K.B., i akuzuari A.M. si dhe mbrojtësi i tij av. B.C. , ndërsa ne seance nuk mori pjese prokurori i Apelit edhe pse ka qene i njoftuar ne mënyre te rregullt.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

#### **Ankesat nuk janë të bazuara:**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin aktgjykim sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoj se i njëjti aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, e as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar gjendja faktike ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë siç parashihet me dispozitat e 248 të KPRK-së, e i cili pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lendes dhe është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ku i njëjti pranim ka mbështetje në faktet që i përmban aktakuza.

Ndërsa sipas pretendimeve ankimore të prokurorisë themelore që ka të bëjnë lidhur me vendimin lidhur me sanksionin penal – *neni 383 par.1 nën par 1.4 të KPPK-së*, për shqiptimin e një dënimi me të lartë dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për shqiptimin e dënimit me të ulët kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat renduese të cilat prokuroria i çek në ankese dhe rrethanat lehtësuese të cilat i çek mbrojtësi i të akuzuarit në kuptim të dispozitave të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, e të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin A.M., ka marrë, se në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se është i moshës së re, ndërsa si rrethane renduese ka marrë intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur andaj, edhe Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar me dënim burgu prej 1 viti, do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr. 520/18 dt. 21.11.2018**

Procesmbajtësi

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit

Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi

Driton Muharremi

